

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, mr.sc. Muhamet Rexha dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve: S., B., Sh., Isuf, M1., A., M2. dhe S. Z., të gjithë nga KK Fushë Kosovë, të cilët me autorizim i përfaqëson Zyra Juridike “K...”, e të gjithë këta i përfaqëson I. R., nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “D.” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Xh. B., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.848/2014 datë 1.6.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.11.2016, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si i pabazuar revizioni i të paditurës KS “D.” me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.848/2014 datë 1.6.2016, në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit material, në emër të shpenzimeve të varrimit paditësve në shumën prej 1.500 € si dhe për dëmin material në automjetin e dëmtuar në shumë prej 387.60 €.

**II. Me pranimin e pjesshëm të revizionit të paditurës, ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.848/2014 datë 1.6.2016, dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.7/2012 datë 21.11.2013 në pjesën që i referohet detyrimit të paditurës që paditësve t’ia kompensojë dëmin jomaterial për vuajtjet e pësuar psikike për shkak të vdekjes së bashkëshortit të paditëses S. dhe babait të paditësve: B., Sh., ., M1., A., M2. dhe S. Z., të gjithë nga Fushë Kosovës, dhe detyrohet e paditura KS “D...” që paditësve, secilit veç e veç, për këtë**

formë të dëmit t'u paguajë shumën prej nga 3.000 €, me pjesën e gjykuar të kamatës nga gjykata e shkallës së dytë. Kërkesëpadia e paditësve mbi shumën e gjykuar refuzohet.

### A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit, të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.848/2014 datë 1.6.2016, refuzohet pjesërisht si e pabazuar ankesa e të paditurës KS "Dardania " me seli në Prishtinë dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr. 7/2012 datë 21.11.2013, në pjesën përkitazi me kompensimin e dëmit jomaterial paditësve për vuajtjet e pësuar psikike për shkak të vdekjes së bashkëshortit të paditëses S. Z., shumën prej 5.000 €, si dhe për vdekjen e babait të paditësve: B., Sh., I., M., Arben, M. dhe S. Z., secilit veç e veç shumën prej nga 3.500 €, si dhe dëmin material për shpenzimet e varrimit shumën prej 1.500 € .

Me pjesën II të dispozitivit, pjesërisht aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, në pikën IV të dispozitivit, përkitazi me kompensimin e dëmit për ngritjen e përmendores si dhe në lidhje me përqindjen e normës së kamatës ndryshohet ashtu që refuzohet pjesa e kërkesëpadiës së paditësve, që ka të bëjë me kompensimin e dëmit material për ngritjen e përmendores për tani të ndjerin B. Z. në shumë prej 1.000 €, si e pabazuar. Ndërsa, në shumat e vërtetuara, kamata i është llogaritur sipas normës e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë datë 21.11.2013 e deri në pagesën definitive.

Aktgjykimi i atakuar në pjesën refuzuese nuk është shqyrtuar.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen vetëm përkitazi me kompensimin e dëmit jo material paditësve.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur në udhëkryqin Lipjan-Magure, nga drejtuesi i automjetit që ka qenë i siguruar tek e paditura, jetën e ka humbur B. Zogjani, bashkëshorti dhe babai i paditësve. Nga çertifikata e kurorëzimit dhe çertifikatat e lindjes, vërtetohet se paditësja S. Z.ka qenë bashkëshortja e të ndjerit, ndërsa paditësit tjerë fëmijët e të ndjerit.

Me ekspertizën e ekspertit të komunikacionit të nxjerrë në procedurë penale nuk është pajtuar pala e paditur dhe me propozimin e të paditurës është caktuar super ekspertiza të cilën e kanë kryer ekspertët e komunikacionit nga Fakulteti Teknik-Dega e komunikacionit. Sipas kësaj ekspertize del se deri te aksidenti ka ardhur si rezultat i lëshimeve primare të drejtuesit të automjetit “Passat” të cilin e ka drejtuar tani i ndjeri, dhe lëshimeve sekondare të drejtuesit të automjetit “WV Kombi”. Lëshimet e drejtuesit të automjetit “Passat” sipas ekspertëve kanë qenë se nuk e kanë respektuar shenjën e ndalimit në hyrje të udhëkryqit (shenjën stop) me qëllim të dhënies së përparësisë së automjeteve në qarkullim në rrugën kryesore, pra, ka ndërmarrë veprimin e kalimit të udhëkryqit pa e siguruar se a janë plotësuar kushtet për kalim të sigurt në komunikacion. Në anën tjetër, lëshimet e automjetit “VW Kombi” kanë qenë sepse është vozitur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar në atë pjesë të rrugës, pra, është vozitur me shpejtësi 80 km/h.

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ia falë besimin ekspertëve të komunikacionit nga Fakulteti Teknik-Dega e komunikacionit dhe kontributin e ndanë në përpjesëtim 40 : 60, ku 40% janë vlerësuar lëshimet e të siguruarit të paditurës ndërsa 60% kontributi i drejtuesit të automjetit “Passat”, tani të ndjerit B. Z.. Andaj, pjesërisht është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësve dhe të gjitha shumat e gjykuara si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e ka zbritur në raport me përqindjen e kontributit në këtë aksident. Kompensimin e dëmit material për paditësit, siç janë shpenzimet e varrimit, ngritjen e lapidarit, janë caktuar duke u bazuar siç thuhet në praktikën gjyqësore në rastet e ngjashme. Ndërsa,

kompensimin e dëmit material në automjet e ka gjykuar duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të makinerisë. Krejt në fund, këtë gjendje të çështjes gjykata e ka bazuar në dispozitën e nenit 200 par. 1 dhe 2 të LMD-së dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e ankimimit ka pranuar qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me përgjegjësinë e të paditurës për kompensimin e dëmit në bazë të kontributit për shkaktimin e dëmit me përqindje 60 : 40. Ka refuzuar ankesën e të paditurës lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jo material paditësve përkitazi me vuajtjet e pësuar psikike për shkak të vdekjes së bashkëshortit dhe babait të paditësve, shpenzimet e varrimit, dhe kompensimin e dëmit material për automjetin e dëmtuar. Ndërsa, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me pjesën IV të dispozitivit ,ashtu që ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve për kompensimin e dëmit për ngritjen e përmendores si dhe përqindjen e normës së kamatës.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se të dy gjykatat drejtë kanë vlerësuar përgjegjësinë e të paditurës lidhur me kompensimin e dëmit sikurse është përcaktuar me dispozitën e nenit 192 të LMD-së dhe nenin 205 të LMD-së, për arsye se nga ana e ekspertëve të komunikacionit është vërtetuar në mënyrë të sigurt fakti vendimtar, se aksidenti është shkaktuar me lëshimet e dy pjesëmarrësve në procedurën drejtuesit të automjetit të siguar tek e paditura dhe me lëshimet e tani të ndjerit B. Z. . Këtë ekspertizë, kjo Gjykatë e pranon si të rregullt dhe mbi këtë bazë gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar të drejtën materiale duke zbatuar principin e përgjegjësisë së ndarë, ashtu sikurse është përcaktuar me dispozitën e nenit 205 të LMD-së.

Për sa i përket shumave të gjykuara me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë paditësve, përkitazi me kompensimit të dëmit material, në emër të shpenzimeve të varrimit në shumën prej 1.500 € si dhe për dëmin material në automjetin e dëmtuar në shumë prej 387.60 janë reale të caktuar nga eksperti përkatës i makinerisë dhe provave përkatëse materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se mbi gjendjen faktike të vërtetuar nuk është zbatuar në mënyrë të drejtë dispozita e nenit 201 par 1 të LMD-së lidhur me nenin 323 të LPK-së, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit material paditësve për vuajtjet e pësuar shpirtërore

për shkak të vdekjes së bashkëshortit dhe babait të paditësve, duke u bazuar në principin e përgjegjësisë së ndarë 60% : 40%. Kjo Gjykatë duke u bazuar në dispozitën e nenit 224. par. 1 të LPK-së, në këtë pjesë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë e ka ndryshuar dhe paditësve në emër të dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore për shkak të vdekjes së bashkëshortit të paditëses së parë dhe babait të paditësve tjerë dhe në përpjesëtim me kontributin në 60% : 40%, ka gjykuar shumat si në pjesën II të dispozitivit të aktgjyimit të kësaj Gjykate, për të cilat shumat konsideron se janë korrekte dhe në pajtueshmëri me vuajtjet e tyre të përjetuara psikike për shkak të humbjes së anëtarit të tyre të familjes si dhe me praktikën e kësaj Gjykate për kompensimin e dëmit të kësaj natyre.

Prandaj, janë të bazuara thëniet në revizion se caktimi i dëmit të kësaj natyre është marrë në bazë të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së dytë drejt ka aplikuar të drejtën materiale në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e dëmit material për ngritjen e përkujtimores për të ndjerin Bajram Zogjani për faktin se paditësit nuk kanë arritur të sigurojnë prova përkatëse për këtë formë të dëmit.

Parashtrimet në revizion lidhur me shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës kontestimore kjo Gjykatë i vlerësoi dhe gjeti si të papranuara për faktin se aktgjykimet e të dy gjykatave nuk janë të përfshira me këto shkelje.

Nga sa u tha më sipër, me zbatimin e nenit 222 dhe 224 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.260/2016 datë 23.11.2016

Kryetare e kolegjit,  
Gyltene Sylejmani